

Software Freedom Conference of Kosova 2009

Prezentim i enciklopedisë së lirë

**Wikipedia**

Petrit Augustini

# Hyrje

Wikipedia është enciklopedi online, e lirë dhe shumë gjuhësore që mund të editohet nga të gjithë. E themeluar në vitin 2001 nga Jimmy Wales dhe Larry Sanger, ajo tani përmban më shumë se 13 milion artikuj në më shumë se 50 gjuhë të krijuar nga vullnetarë prej të gjithë botës, si dhe është burimi më i shfrytëzuar për punë në internet.

## Historia

Wikipedia u themelua më 15 Janar 2001 nga Jimmy Wales dhe Larry Sanger si projekt plotësues për Nupedian, një enciklopedi e lirë online në gjuhën angleze. Wikipedia në fund të vitit 2001 pati 20,000 artikuj në 18 gjuhë. Ajo filloi të zhvillohej me hapa të mëdhenj dhe në vitin 2003 u pavarësua plotësisht nga Nupedia. Më 9 Shtator 2007 Wikipedia në gjuhën angleze e kaloi numrin 2 milion të artikujve, duke u bërë enciklopedia më e madhe në botë, madje duke ia kaluar edhe Yongle Encyclopedia, e cila e kishte mbajtur rekordin për 600 vite me radhë.

Verzioni i Wikipedias në gjuhën shqipe gjithashtu ekziston. Ajo ia filloi më 12 Tetor 2003 dhe sot përmban afër 24,000 artikuj. Wikipedia shqip e ka rendin #58 në listën e Metawiki.

## Wikipedia si enciklopei e lirë

Jimmy Wales, themeluesi i Wikipedias, thekson se një ndër gjërat që e inspiroi më së shumti për ta nisur këtë enciklopedi është pikërisht softweri i lirë dhe i hapur. Wikipedia mund të editohet nga të gjithë, dhe përpos kësaj, përmbajtja e saj është tërësisht e lirë; ajo mund të përdoret dhe të redistribuohet nga çdokush. Kjo karakteristikë e dallon atë nga shumica e enciklopedive tjera. Deri në Qershor të vitit 2009 përmbajtja e Wikipedias ishte e mbuluar nga GNU Free Documentation License (GFDL), pastaj kaloi në Creative Commons Attribution-ShareAlike (CC-by-SA) 3.0..

# Natyra e Wikipedias

Wikipedia bazohet në teknologjinë wiki, websajt që editohet lehtë dhe shpejtë. Kështu ajo bëhet mjaft e përshtatshme për t'u përdorur nga çdokush. Përdoruesit mund të zgjedhin ta editojnë atë në mënyrë anonime apo nëpërmes llogarisë së hapur. Artikujt nuk janë pronë e askujt; ata mund të editohen nga të gjithë. Çdo editim që bëhet regjistrohesh dhe mund të dëshmohet më vonë nga kush është bërë. Çdo artikull e ka faqen e tij të diskutimit, ku komuniteti i koordinon punët midis editorëve mbi atë artikull.

Natyra e hapur e Wikipedias ka tërhequr mjaft kritika. Një ndër kritikant kryesorë bazohet në faktin se lexuesi nuk mund të jetë i sigurtë se artikulli të cilin është duke e lexuar nuk përmban asnjë vandalizëm. Pastaj, Wikipedia nuk mund të garantojë për validitetin e saj, pasi që askush nuk është përgjegjës për përmbajtjen e saj.

Wikipedia e ka për qëllim t'i përfshijë të gjitha përmbledhjet e diturisë njerzore. Ajo nuk është e censuruar; për këtë shkak disa shtete, si p.sh. Kina e kanë bllokuar hyrjen në disa pjesë të saj. Sidoqoftë, përmbajtja e Wikipedias duhet t'ju përmbahet ligjeve të Floridas (ku ajo është themeluar). Secili artikull duhet të jetë I natyrës enciklopedike dhe subjekti i tij duhet të jetë i "shquar"; ai duhet të jetë i përmendur në burime sekondare dhe të pavarura nga vetë subjekti. Së dyti, Wikipedia nuk lejon hulumtim vetjak, ajo lejon vetëm fakte tashmë të njohura dhe të pranuar. Çdo artikull duhet të ketë bazë të jashtme.

Një ndër karakteristikat më të mëdha të saj është neutraliteti. Wikipedia nuk ia mban anën askujt, edhe pse kritikant e kanë sulmur edhe këtë aspekt, duke theksuar se Wikipedia nuk është në gjendje t'i frenojë të gjitha përpjekjet për njëanësi.

## Komuniteti

Ende nuk është e sqaruar mirë se kush bën pjesë në komunitetin e Wikipedias. Sidoqoftë, atë mund ta redaktojnë personat e regjistruar dhe të paregjistruar. Redaktimet anonime regjistrohen duke përdorur IP adresën e redaktuesit. Anëtarëve të regjistruar nuk ju zbulohet IP adresa (edhe pse në raste të veçanta zbulimi I saj mund të kërkohet nga komuniteti). Gjithashtu, anëtarët e regjistruar kanë më shumë privilegje

teknike. Ata mund të bëhen administrues dhe burokratë, çoftë lokal apo global. Wikipedia drejtohet nga komuniteti i saj, i cili krijon rregulla dhe konsensusë, ndonjëherë mjaft të vështira për tu arritur.

## Verzionet gjuhësore

Momentalisht, Wikipedia ekziston në 262 gjuhë; nga këto, 24 kanë mbi 100,000 artikuj dhe 81 kanë mbi 1,000. Sipas Alexa, versioni në gjuhën angleze pranon 52% të vizitave të përgjithshme të Wikipedias.

## Wikipedia shqip

Wikipedia në gjuhën shqipe filloi më 12 Teor 2003. Sot ajo përmban afër 24,000 artikuj.

Wikipedia shqip redaktohet nga shqiptarë dhe të huaj. Ajo ka relativisht pak redaktorë aktiv, shumica e të cilëve jetojnë jashtë Kosovës. Si pasojë e kësaj, gjendja e përgjithshme e Wikipedias shqip nuk është e mirë. Mungesa e kualitetit vërehet në masën dërrmuese të artikujve. Numri i pakët i administruesve dhe përdoruesve të rregullt lejon që artikujt të kenë madje edhe informacione që bien në kundërshtim me rregullat dhe filozofinë e Wikipedias. Kjo gjendje e bën Wikipedinë shqip të mbetet një verzion i pabesueshëm.

## Konkludim

Personalisht, mendoj se Wikipedia është një ndër zbulimet më të rëndësishme intelektuale të njeriut. Gjithmonë kam ëndërruar për një burim i cili ofron informata të çfarëdoshme, të standardizuara, neutrale, dhe pa censurë. Wikipedia i ka këto veti. Përkundër kritikave, mendoj se Wikipedia ka bërë revolucion në botën e diturisë dhe në botën e çdo përdoruesi të saj.